



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 8, datë 28 .02. 2013

**PËR
“EMËRTIMIN “HAXHI DEDE RESHAT BARDHI” TË RRUGËS, NGA NDËRPRERJA
ME RRUGËN “MUHAMET GJOLLESHA” DERI NË BRËNDËSI TË BLOKUT, NË
AFËRSI ME RRUGËN E “KAVAJËS”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), si dhe nenit 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin “Haxhi Dede Reshat Bardhi” të rrugës, nga ndërprerja me rrugën “Muhamet Gjollësja” deri në brëndësi të bllokut, në afërsi me rrugën e “Kavajës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin “Haxhi Dedë Reshat Bardhi” të rrugës, nga ndërprerja me rrugën “Muhamet Gjollësja” deri në brëndësi të bllokut, në afërsi me rrugën e “Kavajës” (sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI**